

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026 Data e dorëzimit: 16 Prill 2026	

Termat e Referencës

për

“Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”



Mars 2026

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026 Data e dorëzimit: 16 Prill 2026	

Sfondi

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është themeluar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS) dhe Fondacioni Shqiptar-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim në formën e “fondacionit”.

FMB vepron në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në mënyrë specifike qëllimi i saj është administrimi indirekt i nënzoneve të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pasuri me vlerë universale, në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 *“Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”*.

Qëllimet e FMB janë të administrojë, ruajë dhe mbrojë asetet e trashëgimisë kulturore të Sitit të Trashëgimisë Botërore të Butrintit. Misioni i Fondacionit është të sigurojë akses publik dhe shërbime, si dhe të promovojë aktivitete studimore dhe kërkimore. Ky mision do të realizohet duke menaxhuar dhe zhvilluar pasurinë kulturore në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar mjetet financiare të nevojshme dhe personelin e specializuar për ruajtjen dhe zhvillimin e saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së administrimit indirekt nga FMB.

Në zbatim të Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit 2020–2030 dhe bazuar në nevojat e evidentuara gjatë vlerësimit të gjendjes së monumenteve dhe strukturave arkeologjike Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit ka hartuar projektin **“Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”**. Ky projekt synon realizimin e ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe konsoliduese në disa prej monumenteve kryesore të qytetit antik të Butrintit, me qëllim ruajtjen e integritetit të tyre strukturor, parandalimin e degradimit të mëtejshëm dhe përmirësimin e prezantimit të monumenteve për vizitorët.

Baza Ligjore

- Ligji 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.
- Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1125, datë 30.12.2020, për “Miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 13.04.2023, “Per miratimin e manualit të çmimeve në ndërtim”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1099, datë 24.12.2020, për “Miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026 Data e dorëzimit: 16 Prill 2026	

- Vendimi i KKTKM, Nr. 527, datë 13.12.2024, për miratimin e “Manualit të Restaurimit”.

Dokumente dhe standarde ndërkombëtare referuese:

- Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (UNESCO, 1972).
- Karta Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve (Karta e Venecias, 1964).
- Karta e ICOMOS për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Arkeologjike (1990).

Përshkrimi i zonës së projektit

Parku Kombëtar i Butrintit përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme arkeologjike dhe natyrore në rajonin e Mesdheut dhe është i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Zona arkeologjike ndodhet në jug të Shqipërisë, në një gadishull të rrethuar nga Liqeni i Butrintit dhe Kanali i Vivarit, duke krijuar një ndërthurje të veçantë midis monumenteve historike dhe ekosistemit natyror përreth.

Butrinti përfaqëson një peizazh kulturor unik ku bashkëjetojnë struktura arkeologjike që i përkasin periudhave të ndryshme historike. Monumente të rëndësishme si Teatri, Baptisteri, Forumi Romak, Gjimnazi, Pallati i Trikonkës dhe strukturat e banjave romake përbëjnë elemente thelbësore të organizimit urban të qytetit antik dhe dëshmi të zhvillimit të tij historik.

Në kuadër të këtij projekti mirëmbajtjeje janë identifikuar për ndërhyrje disa prej monumenteve dhe strukturave arkeologjike më të ekspozuara ndaj proceseve të degradimit, konkretisht:

1. Teatri
2. Banjat Romake pranë Teatrit
3. Pallati i Trikonkës
4. Gjimnazi
5. Forumi Romak
6. Baptisteri
7. Banjat Romake pranë Baptisterit
8. Porta e Luanit
9. Sheshi i Ugolinit

Këto monumente janë pjesë e rëndësishme e itinerarit turistik të parkut dhe frekuentohen rregullisht nga vizitorët, duke e bërë të domosdoshme ruajtjen e stabilitetit të tyre strukturor dhe vlerave historike.

Për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm ndaj kushteve natyrore dhe faktorëve atmosferikë, strukturat arkeologjike të Butrintit janë subjekt i proceseve të vazhdueshme degradimi. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në gjendjen e tyre teknike përfshihen:

- erozioni dhe depozitimi i materialeve të ndryshme në zonat përreth monumenteve;
- veprimi i ujit dhe lagështisë, veçanërisht në zonat pranë liqenit;

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026 Data e dorëzimit: 16 Prill 2026	

- zhvillimi i vegjetacionit mbi dhe ndërmjet strukturave;
- degradimi gradual i materialeve lidhëse dhe dobësimi i muraturave.

Si pasojë e këtyre faktorëve, në disa segmente të monumenteve konstatohet dobësim i strukturave, zhvendosja e blloqeve të gurit, prania e depozitimeve biologjike dhe aluvioneve, si dhe humbja e stabilitetit të disa elementeve arkitektonike. Këto procese ndikojnë jo vetëm në ruajtjen e integritetit fizik të monumenteve, por edhe në sigurinë e vizitorëve që frekuentojnë zonën arkeologjike.

Në këtë kontekst, projekti i mirëmbajtjes parashikon ndërhyrje konservuese në monumentet e identifikuar, duke synuar stabilizimin e strukturave ekzistuese dhe parandalimin e degradimit të mëtejshëm.

Qëllimi dhe objektivat kryesorë

Qëllimi i projektit është parandalimi i degradimit dhe dëmtimit të mëtejshëm të monumenteve dhe strukturave arkeologjike nëpërmjet realizimit të ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe konsoliduese që synojnë ruajtjen e integritetit të tyre strukturor dhe historik.

Objektivat e projektit të investimit

Objektivat kryesorë të këtij projekti janë:

- Të përforcojë dhe stabilizojë strukturat e rrënojave arkeologjike dhe monumenteve të pëcaktuara në këtë projekt;
- Të shmangë shkaqet që çojnë në degradimin e shpejtë të strukturave;
- Të minimizojë efektet e erozionit, lagështisë dhe vegjetacionit mbi monumentet;
- Të ruajë integritetin fizik dhe materialet origjinale të strukturave arkeologjike përmes ndërhyrjeve konservuese;
- Të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe stabilitetin e monumenteve.

Përshkrimi i ndërhyrjeve të parashikuara

Punimet që do të realizohen në kuadër të këtij projekti do të përfshijnë:

- Pastrimin e zonave nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë;
- Trajtimin e rrënjëve dhe bimësisë invazive që dëmton strukturat;
- Konsolidimin e muraturave me gurë dhe llaç gëlqereje sipas teknikave tradicionale të restaurimit;
- Pastrimin e depozitimeve biologjike dhe aluvioneve;
- Sistemin e terrenit përreth strukturave;
- Marrjen e masave mbrojtëse për stabilizimin e strukturave dhe mbrojtjen nga erozioni;
- Organizimin dhe sinjalizimin e zonës së punimeve gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhjyry mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026	Data e dorëzimit: 16 Prill 2026

Punimet do të realizohen në përputhje me projektin teknik dhe specifikimet teknike të miratuara.

Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e punimeve do të jetë sipas grafikut të punimeve të përfshirë në dokumentacionin teknik të tenderit.

Kërkesat për Ofertuesit

- 1.1. Subjekti ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në ndërhjyry në pasuritë kulturore materiale, si person juridik në zbatim, **në kategorinë N-Z/A/1 – “Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike”**, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.2. Drejtuesi teknik i punimeve restauruese duhet të jetë i pajisur me **licencë individuale restaurimi në kategorinë Z/A/1**, sipas klasifikimit për zbatimin e punimeve në site arkeologjike.

2. Kapaciteti teknik dhe profesional

Subjekti ofertues duhet të disponojë staf profesional të kualifikuar për realizimin e ndërhjyryve. Ky staf duhet të përbëhet nga:

- 2.1. Drejtues teknik restaurimi, i pajisur me licencën përkatëse Z/A/1, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin teknik të punimeve restauruese dhe duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, sipas kërkesave të specifikimeve teknike.
- 2.2. Një Inxhinier ndërtimi, përgjegjës për aspektet konstruktive, organizimin teknik të zonave ku do të kryhet mirëmbajtja, dhe koordinimin e punimeve ndihmëse në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.
- 2.3. Specialist i çertifikuar për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë HSE, përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë realizimit të punimeve.
- 2.4. Teknik Ndërtimi me diplomë të arsimit të mesëm profesional.

Gjithashtu, subjekti ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 20 punëtorë të dedikuar për realizimin e këtij shërbimi.

3. Organizimi i punimeve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një përshkrim të organizimit të punimeve, i cili duhet të përfshijë:

- metodologjinë e realizimit të punimeve restauruese;
- organizimin e kantierit;
- planin e menaxhimit të sigurisë në punë;
- masat për mbrojtjen e monumentit dhe të mjedisit përreth gjatë zbatimit të punimeve.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 006 / 2026	0
Projekti: “Ndërhyrje mirëmbajtëse në monumentet e Parkut Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 17 Mars 2026 Data e dorëzimit: 16 Prill 2026	

Shëndeti dhe siguria:

I gjithë personeli i përfshirë në punime duhet të respektojë protokollet e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Këto përfshijnë:

- përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes personale (PPE);
- respektimin e rregullave të sigurisë në kantier;
- sigurimin e zonës së punimeve për vizitorët;
- mbrojtjen e monumentit dhe të ambientit përreth gjatë ndërhyrjes.

Dokumentacioni i Tenderit:

Për marrjen e dokumentacionit të tenderit si më poshtë, dërgoni kërkesën tuaj në email-in tenders@bmf.al :

1. Projekt Zbatimi
2. Grafik Punimesh
3. Preventiv
4. Relacion Teknik
5. Specifikime Teknike

Komunikimi gjatë tenderit

Gjatë periudhës së tenderit komunikimi për pyetje do të bëhet vetëm nëpërmjet e-mail-it në adresën tenders@bmf.al